Groupe FICADEX

FICADEX ALBANIA

RAPORTI I AUDITOREVE TE PAVARUR

Auditimi i pasqyrave financiare

Viti fiskal që perfundon më 31 Dhjetor 2014

Partia "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE"

Adresa - mungon

Subjekti - Parti Politike

Partia "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE"

Pa adresë

Audituar nga:

Marije DUSHI

"FICADEX ALBANIA" Ltd

"Mrgjeni" street ,147 Q 4, Durres - Albania;

Tel/fax + 355 52 37 859

Misioni

Auditimi i fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin fiskal 2014

Raporti

Data 21 Tetor 2015

Versioni: Final

Deklaratë përgjegjësie

Partia "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE", Parti Politike, nuk ka deklaruar asnje referencë për kontakt, mangësi e cila e bëri të pamundur kontaktimin e drejtimit të saj nga ana jonë për të kryer auditim e fondeve të përftuara dhe shpenzuara të vitit 2014.

Përmbajtja **Faqe**

Raporti i Auditorëve të Pavarur

me

Pasqyrat financiare të partisë, të audituara – Pa informacion

- Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2014; Pa informacion
- Pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve për periudhën për vitin 2014; Pa informacion
- Pasyra e lëvizjes së parasë për vitin 2014 Pa informacion
- Pasqyra e lëvizjes së fondeve të veta për vitin 2014 Pa informacion
- Regjistri i posaçëm për shumën e fondeve jopublike të përftuara nga personat fizik e juridik shqiptar për vitin 2014 Pa informacion
- Shënime mbi Pasqyrat Financiare për *për vitin 2014* Pa informacion

Skeda suplementare për pasqyrat financiare:

- Pasqyra e llogarive bankare të veçanta dhe të projektit për *për vitin 2014*; Pa informacion

"FICADEX ALBANIA" Ltd
Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania

Mobile: + 355 69 40 52 787
Tel/fax : + 355 52 2 37 859
E-mail : alficadex@gmail.com ; alficadex@hotmail.com; marjadushi@gmail.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Pallati i Kongreseve, Tiranë

Me vendimin nr. 969, datë10 Gusht 2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jemi caktuar me short për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për vitin financiar 2014, për Partinë "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE", dhe kemi lidhur kontratën nr.7688 Prot., datë 25.09.2015.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi i Partisë "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare" ka përgjegjësi të përgatisi pasqyrat financiare për fondet e përftuara dhe të shpenzuara për vitin që përfundon në 31.12.2014 që përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar (bilanci kontabël); pasqyra e fondeve të përftuara dhe shpenzuara (pasqyra e performancës financiare), e cila tregon të ndara fondet e përftuara nga çdo burim, pasqyrën e flukseve të parasë, pasqyrën e lëvizjes së burimeve të veta në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012). Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në auditimin tonë. Për shkaqet që janë përshkruar në paragrafin *"Bazat e refuzimit për të dhënë opinion"* ne nuk e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012). Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arësyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e proçedurave për të marë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Proçedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve dhe anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që lidhet me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të planifikuar proçedura të përshtatëshme auditimi për rrethanat përkatëse, por jo me qellim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Prandaj ne nuk shprehim një opinion të tillë. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"FICADEX ALBANIA" Ltd
Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania
Mobile: + 355 69 40 52 787
Tel/fax : + 355 52 2 37 859
E-mail : alficadex@gmail.com; alficadex@hotmail.com; mariadushi@gmail.com

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

Bazat e refuzimit për të dhënë opinion

1) Megjithë përpjekjet tona për të siguruar referenca kontakti (adresën e selisë së Partisë, të vendbanimit apo adresë tjetër të mundëshme, numër telefoni apo adresa e-maili), nuk u bë e mundur kontaktimi me drejtimin e Partisë "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare". Ne nuk mundëm të dispononim pasqyrat financiare të vitit fiskal që përfundon më 31.12.2014, dokumentacionin vërtetues përkatës mbi bazën e të cilit janë përgatitur këto pasqyra, si dhe informacione të tjera, që të mundësonte auditimin tonë sipas kërkesave të SNA dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012).
2) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 23 Prot., datë 06.10.2015, Gjykata e Rrethit Tiranë (Regjistrit), Nr. 12 650/1 Prot., datë 14.10.2015 na informoi se regjistrimi i Partisë është bërë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 785, datë 07.03.2001. Adresa e dhënë në këtë vendim regjistrimi Rr."Tefta Tashko", Pll. 174/12 nuk u gjënd. Në Regjistër nuk janë depozituar vendime të Asamblesë për ndryshime të mëvonëshme statutore, përfshirë edhe adresën.
3) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 24 Prot., datë 12.10.2015, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRTT), me shkresën Nr. 72739 Prot., datë 16.10.2015 na informoi se Partia "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare" nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga neni 40, pika 4/4.1.a dhe neni 42, i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare të vitit fiskal që përfundon më 31.12.2014 që sipas kërkesave të nenit 29, ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar)
4) Partia "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare" nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare në KQZ për vitin që përfundon në 31.12.2014, sipas kërkesave të nenit 23, ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" (i ndryshuar).

Refuzim për të dhënë opinion

Për shkak të kufizimeve të rëndësishme siç janë përshkruar në paragrafin *"Bazat për refuzimin e dhënies së opinionit"*, nuk na u mundësua marrja e evidencës së auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatëshme për të dhënë opinionin tonë. Për këtë arësye ne nuk mund të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare për fondet e përftuara dhe të shpenzuara të Partisë "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE" për vitin fiskal që përfundon më 31.12.2014, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012)), pasi nuk jemi në kushtet e një auditimi ligjor sipas SNA.

Tiranë 21 Tetor 2015

Marije DUSHI - EKR
FICADEX ALBANIA SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës

Deklarime të audituesit të pavarur
Në vend të shënimeve mbi pasqyrat financiare
Viti fiskal që përfundon më 31.12.2014

---

1. Deklarime të audituesit,

Në mungesë të çdo informacioni për Partinë "LËVIZJA MONARKISTE DEMOKRATE SHQIPTARE" (adresë, nr. kontakti...), ne iu drejtuam me shkresë zyrtare, Gjykatës së Regjistrit dhe Organeve tatimore (konkretisht DRTT), për të siguruar informacion për:

a) Adresën ose kontakte të tjera;

b) Regjistrim në regjistrin e Partive me vendim të Gjykatës së Tiranës (Regjistri);

c) Depozitim të pasqyrave financiare të vitit 2014 në Organet Tatimore dhe KQZ.

Në përgjigje të kërkesave tona morëm përgjigjet e mëposhtëme:

1) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 23 Prot., datë 06.10.2015, Gjykata e Rrethit Tiranë (Regjistrit), Nr. 12 650/1 Prot., datë 14.10.2015 na informoi se regjistrimi i Partisë është bërë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 785, datë 07.03.2001. Adresa e dhënë në këtë vendim regjistrimi Rr."Tefta Tashko", Pll. 174/12 nuk u gjënd. Në Regjistër nuk janë depozituar vendime të Asamblesë për ndryshime të mëvonëshme statutore, përfshirë edhe adresën.
2) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 24 Prot., datë 12.10.2015, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRTT), me shkresën Nr. 72739 Prot., datë 16.10.2015 na informoi se Partia "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare" nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga neni 40, pika 4/4.1.a dhe neni 42, i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare të vitit fiskal që përfundon më 31.12.2014 që sipas kërkesave të uenit 29, ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar)

Me kërkesë verbale iu drejtuam KQZ për informacione të tjera, dhe u informuam se:

Partia "Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare", nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare në KQZ për vitin fiskal që përfundon uë 31.12.2014, sipas kërkesave të nenit 23, ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" (i ndryshuar).

Nisur sa më sipër, nuk u mundësua disponimi i pasqyrave financiare të vitit 2014, përgaditur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012), si dhe dokumentacioni përkatës, për të bërë të mundur auditimin.
Si pasoje, ne nuk ishim në kushtet e një auditimi ligjor të pasqyrave financiare sipas SNA.

Marije DUSHI - EKR
FICADEX ALBANIA SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës

GJYKATA RRETHIT GJYQ.
Nr. 2102 Akti

Nr. 785 Vendimi

Levizja Monarkiste

785

7.3.2008

K. Tefta Tashko

Pll. 174/12

V E N D I M

" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e rrethit Tirane e perbere prej:

Gjyqtare Enkela Bajo

Asistuar prej sekretares Natasha Azemaj,sot ne dt.07.03.2001,mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me nr 2102 Akti qe i perkete:

K E R K U E S: Guri Durollari, i biri i Rapushit,dt.1lindje 193 banues ne Tirane,Rr. " Tefta Tashko",pll.174/12.

O B J E K T I: Regjistrimin si person juridik i Partise " Lev zja monarkiste Demokrate Shqiptare".

Baza ligjore: Neni 9 i K.R.SH dhe ligji 8580 dt.17.02.2000," P artite politike".

Gjykata pasi administroi provat shkresore e degjoi pretendi e kerkuesit dhe e shqyrtoi ceshtjen ne teresi:

V E R E N:

Se para gjykates se rrethit Tirane eshte paraqitur nje kerkese me anen e te ciles kerkohet regjistrimi si person juridik i partise Levizja Monarkiste Demokratike Shqiptare". Pas verifikimit te bere ng gjykata,u provua se emri i kesaj partie nuk e ka ndonje parti tjeter. Ne mbledhjen e dt.15.12.2000 te antareve themelues,pasi eshte diskutu statuti dhe programi i Partise,me unanimitet eshte vendosur:Themelimi i Partise " Levizja monarkiste demokratike Shqiptare",miratimi i statuc dhe programit i saj,si dhe eshte zgjedhur si kryetar partie Z.Guri Du llari.Kjo parti ne referenc te dokumentacionit te paraqitur prane Gj kates,eshte nje organizate politike, e pavarur, e hapur dhe e gjitho veprimtaria e saj eshte ne perputhje me ligjislacionin ne fuqi.Qellim dhe objektivat e kesaj partie te parashtuara ne programin e saj jane:

- Ne fushen politike.

Partia " Levizja monarkiste demokratike Shqiptare" ne mbeiale Pll. duke qene gjithnje nje parti legjitimiste e konsideron si gabim nist rik frenimin qe politika shqiptare po i ben ceshtjes se referendumit, per arsyete duke qene se ne fakt eshte partia qe vazhdon rrugen e gje

me te vjeter qe prej themelimit te shtetit shqiptare,pa [illegible] nga ceshtja e referendumit per formen e shtetit hyn ne cdo zgjedh lokale me mendimin e saj per te pasur edhe ajo zerin ne parlament shqiptare gjithmone ne funksion te ligjitimitetit dhe te ceshtjes kombetare.

P.L.M.D.SH ne politiken e brendeshme kerkon te sjelle paqen e v tete shoqerore,sepse kjo paqe lidhet drejteperdrejte me politiken zonale dhe kombetare,per nje shqiperi te bashkuar,per nje shtet Shqiptar brenda te cilit te permblidhen te gjitha etnia Shqiptare qe ndodhet ne trojet e pa nderprera ne Gadishullin e Ballkanit. Kjo Parti deshiron realisht emancipimin e politikes shqiptare dhe shpreson te beje te gjitha perpjekjet per permiresimin cilesor te klases politike Shqiptare e cila sot eshte ende e turbullt dhe pa nje opinion civik per ceshtjen kombetare.PLMDSH e konsideron poli ken si instrument per realizimin e programit te nje partie ne qev risje,por ajo asnjehere nuk do te shkele parimet morale ne reali zimin e politikes dhe do te jete abonence e hapur ndaj cdo politi ke,qe do te cenoje ne shqiperi lirime dhe personalitetin e njeriu Ajo do te jete gjithmone per nje politike te drejte sociale,te mb tjetjes reale te shtresave te varfra dhe do te jape gjithmone kon butin e saj per ngritjen e nivelit zyrtar te varferise ne Shqiper i cili aktualishte eshte ende shume i ulet.Brenda rivleresimit re te prones ne Shqiperi,eshte menduar se ecuria normale e reformes nomike do te zhvillohet me rivleresimin juridik te shtetit Shqip per periudhen 1926 - 1939.Ne ristrukturimin e sistemit financia atij bankar dhe konvertimit te lekut,P.L.M.D.SH. ka skemen e saj te strukturimit,si bankat private,krijimin e tre tregjeve - Treg financiar,punes dhe ngritjes se nivelit bashkekohor te sistemit fiskal.Kjo parti e sheh si nevoje imediate ngritjen e nje banke vate bujqesore,per te krijuar me anen e kreditit zhvillimin int ral te bujqesise,si dhe permiresimin e raportit midis prones se tur dhe asaj te re mbi token ne shoqerine Shqiptare.

Ne fushen sociale:P.L.M.D.SH. ne funksion te unitetit kombet raqet para shoqerise Shqiptare obsjonin e vete per zhylljen re te [illegible] te se kaluares.Ajo kerkon qe ne emer te se ardhmes [illegible]

qe te strukturoje realishte jeten shoqerore ne ate menyre [illegible] ins
tucionale e cila mbi te gjitha do te sheshonte te gjitha kontraditat
jetes aktuale shoqerore ne Shqiperi.P.L.M.D.SH. konstaton 5 konflikte
te cilat kerkojne qe ti eleminoje.Sipas saj keto konflikte jane:Konf
likti i pare ai zonal e krahinor, i dyti eshte ai mes pushtetit qendr
dhe atij lokal.Per kete kjo Parti shpalos si mendim te vetin ate te p
varesise reale juridika dhe institucionale te pushtetit lokal.Konflik
i treete eshte ai mes feve.Per kete partia propozon mirkuptim dhe pran
min real te tre besimeve ekzistente ne Shqiperi,ne menyre qe besimi t
mos jete mjet percares por mjet per ndricimin e shpirtit.Konflikti i k
ter eshte ai mes principeve demokratike te strukturimit te shtetit t
ri shqiptare dhe mos zhvillimin e nje referendumi per zgjidhjen e for
se shtetit - Republike apo Monarki, sepse sipas tyre referendumi mund
te ndryshoje demokratisht kapercimin e ndertimit shteteror nga monark
ne Republike. Konflikti i peste eshte ai mes shtetit dhe individit.Pe
kete kjo parti do te marre pjese aktive ne formulimin e nje kushtetut
Shqiptare.Po L.M.D.SH. eshte e sigurte,monarkia i jep shprese cdo idi
vidi per te garantuar dinjitetin dhe personalitetin e tij ndaj perdho
jes qe mund te beje pushteti ekzekutiv apo vete politika.Kjo shprese
perqendrohet tek virtutet e mbretit i cili duke qene realisht simbol
unitetit Kombetar,eshte patjeter dhe ruajtes i palekundur i dinjiteti
dhe personalitetit te pacenuara te shtetitve te vete,ne nje shqiperi
etnike ne menyren paqesore mbi bazen e zhvillimit te diallogut.

Ne fushen ekonomike: Reforma ekonomike ndonese e ka permiresua
rivleresimin e pronave nuk ka bere te mundur qe ky rivleresim te jete
juridik brenda principeve dhe frymes se te drejtes moderne te ristruk
turimit.Per keto arsye P.L.M.D.SH. mendimin e vete ekonomik e vendos
qender te harmonizma midis prones se vjeter te regjistruar saktesish
dhe depozituar ne analet e shtetit,me pronen e re qe ka filluar te lu
lezoje ne shqiperi pas permbushjes se komunizmit.Brenda rivleresimit
real te prones ne Shqiperi,eshte menduar se kjo ka lidhje te drejte p
drejte me ecurine juridike te shtetit Shqiptare qe nga themelimi e de
ne diten e sotme.Ketu vlen te theksojme parimin se prona private esht
e shenjte dhe e paprekeshme,baza dhe garancia e qyteterimit njerezor.
Kjo parti u njoh te gjithe titujt pronesor pronareve te tyre te ligjo
shme,per rastet e pamundura pronaret te kompesohen nga shteti.Kjo do

jete kunder edo lloj eksperimenti te kryer ne emer te "revolucionit apo " reformave" te motivuara nga qendrimi idiologjik qe eonojne si terine e prones private.P.L.M.D.SH. e sheh si detyre mediate te ek nomise se ngritjes e nje Banke private Bujqesore per te krijuar me ane te kreditit,zhvillimin integral te bujqesise si dhe permiresimi e raportit midis prones se gjithe vjeter dhe asaj te re ubi token ne shoqerine Shqiptare.Ne rritjen e mireqenies se vendit partia jone eshte qe ne shqiperi sa me pare te zhvillohet turizmi cilesor,ti jepet perparesi industrise se lehte e ushqimore dhe atyre degeve te ekonomise me efektivitete te larte.Te stimulohet me te gjitha mjete dhe menyrat zhvillimi i infastruktures si:E autistradave,trasporti ajror,hekurudhor e detar,telekomunikacioni etj.Te zhvillohen ato de te industrise se lehte e te rende,nxjerrese e perpunuese per te cil sigurohet lenda e pare ne vend dhe qe kane efektivitet te larte.Sy nohet modernizimi i bujqesise dhe fshatit ku funksionojne ferma individuale apo kolektive te barazuara me inisiativen e lire,ngritj e nivelit te larte te bazes materiale,tregtare,postare,telefonizmi, urbanizmi dhe te zhvillimit te turizmit ne fshat.Po ashtu synohet funksionimi i nje sistemi dinjitoz te asistences sociale,organizim per nje emigracion te organizuar dhe te drejtuar nga shteti ne per puthje me ligjet nderkombetare.

Organet drejtuese te partise jane: Kongresi,Keshilli Kombetar, Kryesia e Partise,Kryetari.

Organet e tjera jane te percaktuara hollesisht ne statut.

Te drejtat e detyrat e antareve te Partise jane te percaktuar ne statut.Te tilla jane:E drejta per tu zgjedhur dhe per te zgje dhur,per te shprehur mendimin e lire,detyrimin per te paguar kuot e antaresimit, te zbatoje programin e Partise etj.

Burimet financiare te partise jane: Kuotizacioni i antaresise te ardhurat e realizuara nga agtypi e botimet e ndryshme,te organ zuara nga partia, si dhe te ardhurat e tjera te mundeshme.

Emri i plote i Partise eshte " Partia Levizje Monarkiste Je krate Shqiptare" dhe inicialet te saj L.M.D.SH.

- Selia e kesaj partie eshte ne Tirane,Rr. " Teffta Tashko",

mbi 500 antare themelues te cilet kane deshire due vullnetin e tyre te l
lire e te plote per themelimin e saj dhe pranojne statusin dhe programin
e saj.

Per sa me larte,gjykata e cmon te drejte kerkesen dhe si te tille e pranon.

Per keto arsye

Gjykata bazuar ne neni 306 te K.Pr.Civile

V E N D O S I:

- Pranimin e kerkeses.

- Regjistrimin si person juridik te Partise " Levizja Monarkiste Demo krate Shqipetare".

- Partia Levizja monarkiste Demokrate Shqiptare eshte nje bashkesi politike e pavarur,e hapur e organizuar mbi bazen e vullnetit te lire te shtetasve shqiptare,veprimtaria e te ciles eshte ne perputhje me ligjis lacionin ne fuqi.

- Qellimi dhe objektivat e saj jane te percaktuara ne programin dhe statutin e saj.

- Organet drejtuese te partise jane: Kongresi, Keshilli Kombetar,Krye sia e Partise,Kryetari.

- Kryetari i Partise i zgjedhur ne mbledhjen themeluese te dt.15.12. 2000 eshte Guri Dukollari.

- Organet e tjera jane te percaktuara ne statut.

- Burimet financiare jane te perbera nga :Kuotizacionet e antareve te ardhurat e realizuara nga shtypi e botimet e ndryshme, organizuara nga partia,si dhe te ardhurat, te ligjshme tjera te mundeshme.

- Shperberja e saj behet sipas statutit dhe ligjislacionit ne fuqi.

- Emri i plote i Partise eshte " Levizja monarkiste Demokrate Shqi tare" me inicjale P/L/M.D.SH.

- Selia qendrore eshte ne Tirane,Rr. " Tefta Tashko",pll.174/12.

- Flamuri ka emblemen,flamurin dhe vulen e saj,te percaktuar ne statut.

- Numri i antareve eshte mbi 500 antare,shtetas Shqiptare.

- Shpenzimet gjygesore sic jane bare.

- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane,brenda 15 ditove,afat ky qe fillon nga dita e shpalljes se vendimit.

U shpall no dt.7.[illegible].2001

S E K R E T A R E

NATASHA AZEMAJ

G J Y Q T A R E

ENKELA BAJO